

## **RREGULLORE PER SHPERBLIME DHE DENIME**

### **DISPOZITAT THEMELORE**

#### **Neni 1**

Me këtë Rregullore vërtetohen llojet e lëvdatave dhe çmimeve për nxënësit në SH.F."Bratstvo Migjeni" Tetovë, si dhe mënyra e aplikimit të tyre.

### **LËV DATAT DHE ÇMIMET**

#### **Neni 2**

Nxënësit të cilët janë treguar me punën dhe sjelljen e tyre ,të cilët treguan rezultate të larta në mësim dhe aktivitetet jashtëmësimore,mund të jenë të lavdëruar dhe shpërblyer.

#### **Neni 3**

Me lëvdatat dhe çmimet stimulohet zhvillimi i karakteristikave (vetive) pozitive te nxënësit,përforcohet besimi në mundësitë e tyre si dhe ju jepet mirrenjohje për sukseset pozitive në veprimtarinë edukativo-arsimore

#### **Neni 4**

Lëvdata dhe çmime ju jepet edhe:

- Paralele të cilat në veçanit tregojnë sukses,sjellje dhe rregullësi gjatë kryerjes së obligimeve shkollore;
- grupë nxënësish,seksion ose ekipë të cilët arrijnë rezultatetë veçanta (vendin e parë,të dytë dhe të tretë ) në gara;
- paralele,grupë ose seksion që arrijnë rezultate më të mira në aktivitete të caktuara të organizuara në shkollë ose jashtë saj (humanitare,edukative,kulturore,sportive e të tjera)

#### **Neni 5**

Lëvdatat dhe çmimet ju jepen: nxënësit,grupë nxënësish, seksion nxënësish, ekipe dhe paralele në vijim,fund të vitit shkollor,Ditës së shkollës ose ditës së edukatorëve slloven dhe Ditës së mësuesit me mësim në gjuhën shqipe

#### **Neni 6**

Justifikim për lëvdata dhe çmime jep:

- arsimtarë klasor,
- arsimtari lëndor ,
- kujdestari i klasës ,
- punëtorët profesional,
- drejtori,
- komisioni shkollor,

Vendim sjell Këshilli arsimor.

#### **Neni 7**

Lëvdatat jepen me gojë ose me shkrim.

Lëvdatat gojore komunikohen para nxënësëve nëpërmjet stacionit publicitar ose nëpërmjet lajmërimit,

Lëvdatat me shkrim jepen në formë të diplomave,lëvdatave ose mirrënjohje.

#### **Neni 8**

Çmimet jepen në formë të vlerave të caktuara që përgjigjen me qëllimin e tyre pedagogjik (lëvdatë,libër,pajisje për nxënës e tj.)

#### **Neni 9**

- (1) Dhënia e lëvdatave dhe çmimeve normalisht kryhet në mënyrë ceremoniale para nxënësëve të paraleles, respektivisht shkollës
- (2) Dita e dhënies së lëvdatave caktohet me Vendim të arritur në këshillin arsimor.

#### **Neni 10**

- (1) Lëvdatat dhe çmimet e nxënësëve mundt të jepen edhe për rezultate të arritura gjatë aktiviteteve të ndryshme (konkurse,gara,ekspozita e tj.) të organizuara nga institucione tjera ose organizta në shoqërinë lokale dhe më gjërë.
- (2)Vendimin për lëvdatat ose çmimet nga paragrafi 1 në këtë nen,si dhe kohën për ndarjen e tyre e cakton organizatori i atyre aktiviteteve

### **NXËNËSI MË I MIRË I GJENERATËS**

#### **Neni 11**

- (1) Nga nxënësit deri në klasën e nëntë zgjidhet nxënësi më i mirë i gjeneratës për secilin vit shkollor
- (2)Nga nxënësit e klasës së nëntë zgjidhet nxënësi më i mirë i gjeneratës nga nxënësit të cilët e mbarojnë shkollën fillore (më tutje:nxënës i gjeneratës) gjatë secilit vit shkollor.

#### **Neni 12**

Propozim për nxënës –kandidat për nxënës më të mirë të gjeneratës mund të jep: kujdestari i paraleles(klasës),arsimtari lëndor,punëtori profesional ose drejtori.

#### **Neni 13**

Secili nxënës i propozuar ose i kadiduar është i obliguar deri te Komisioni shkollor për lëvdata dhe çmime të dorëzojë dokumentacionin e duhur (e nevojshëm).

#### **Neni 14**

- (1)Komisioni shkollor për lëvdata dhe çmime e përbëjnë tre arsimtarë të cilët i emëron Këshilli i arsimorë i shkollës për secilin vit shkollor veçanërisht nga rradhët e arsimtarëve të cilët nuk janë kujdestarë klase të klasës së nëntë dhe që nuk kanë qenë kujdestarë klase të asaj gjenerate të nxënësëve.
- (2) Në punën e Komisionit shkollor marrin pjesë edhe dy nxënës të zgjedhur nga udhëheqësia e Bashkësisë së nxënësëve të shkollës dhe të cilët nuk janë kandidat për nxënës më të mirë të gjeneratës.
- (3)Në punën e Komisionit shkollor marrin pjesë edhe punëtorët profesional të shkollës.

#### **Neni 15**

Komisioni për lëvdata dhe çmime e shqyrton dokumentacionin e përgjithshëm të kandidatëve të paraqitur ,i zbaton kriteriumet e kësaj rregullorje ,pregaditë listë pikësh(poenash),vendos propozimin e nxënësit për nxënës më të mirë të gjeneratës dhe propozimin me listën e pikëve e paraqet deri te Këshilli i arsimtarëve.

#### **Neni 16**

Komisioni për lëvdata dhe çmime e shqyrton dokumentacionin e përgjithshëm të kandidatëve të paraqitur ,i zbaton kriteriumet e kësaj rregullorje ,pregaditë listë pikësh(poenash),vendos

propozimin e nxënësit për nxënës më të mirë të gjeneratës dhe propozimin me listën e pikëve e paraqet deri te Këshilli i arsimtar

#### **Neni 17**

(1) Vendimin për shpallje të nxënësit më të mirë të gjeneratës e sjell Këshilli arsimor.

(2) Për nxënës më të mirë të gjeneratës mund të shpallet nxënës i cili :nuk ka të shpallur masë pedagogjike gjatë shkollimit,në kontinuitet ka sjellje të shkëlqyeshme,tregon sjellje shembullore në shkollë dhe jashtë saj,ka në kontinuitet sukses të shkëlqyeshëm në të gjitha lëndët mësiore,arin rezultate në gara në emër të shkollës,në mënyrë aktive mer pjesë në aktivitete të lira ,tregon aktivitete në punë gjatë organizimeve të nxënësëve,ka çmime të fituara,diploma ose mirrënjohje tjera në konkurse për vizatim,literaturë ose lloj tjetër të konkursit në emër të shkollës.

#### **KRITERIUME PËR ZGJEDHJE TË NXËNËSIT MË TË MIRË TË GJENERATËS**

#### **Neni 18**

Në bazë të dokumentacionit të ofruar të nxënësit –kandidat dhe qasja në evidentimin pedagogjik,Komisioni shkollor për lëvdata dhe çmime kryen shënimin(bodimin) e nxënësëve sipas kruteriumeve vijuese:

1.Pjesëmarje dhe vend të fituar në gara në lëndë arsimore-Niveli i garës-Vendi i parë,Vendi i dytë,Vendi i tretë,Pjesëmarje individuale,,Grupore,Gara shkollore,Gara të përgjithëshme,Gara ndërkombëtare rajonale.

2.Pjesëmarje dhe vend të fituar në konkurse,ekspozita për vepra të artit,shfaqje muzikore,vepra letrare,dramatike recitm ose krijimtari teknike (Vendi i parë,Vendi i dytë,Vendi i tretë) .pjesëmarje individuale,ekipore në:Gara shkollore,Gara të përgjithshme rajonale,Gara shtetërore,Gara ndërkombëtare.

3.Pjesëmarje dhe vend të fituar në gara sportive (Vendi i parë,Vendi i dytë,Vendi i tretë) pjesëmarje individuale,ekipore në:Gara shkollore,Gara të përgjithshme rajonale,Gara shtetërore,Gara ndërkombëtare .

4. Për sukses të shkëlqyeshm në kontinuitet nga klasa e parë deri në klasën e nëntë.

5. Për kryerjen e rolit përgjegjës në aktivitetet e Bashkësisë së nxënësëve të paraleles,Bashkësisë së nxënësëve të shkollës,të rrinjtë e kryqit të kuq ose tjetër organizate të nxënësëve.

Nxënësi fiton nga një pikë për secilin kriterium.

#### **Neni 19**

Në rast të pikëve të njejta, nxënës i Gjeneratës është ai i cili ka numër më të madh pikësh sipas rendit të kriteriumeve nga 1 deri në 5.

#### **Neni 20**

Nxënësi i cili është shpallur nxënës i klasës i ndahet diplomë dhe çmim \_\_\_\_\_

Ndarja e çmimeve për nxënës më të mirë kryhet në solemnitetin(ceremoninë ) që oganizohet për nxënësit të cilët e mbarojnë shkollën fillore

#### **Neni 21**

Kjo rregullore hyn në fuqi nga dita e miratimit

**DREJTORI/ RIZA ETEMI**